

L I G J

Nr. 9424, datë 6.10.2005

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i vlerësimit strategjik mjedisor”, hartuar në kuadër të Konventës “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4673, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr 77 , Faqe 2553 , Data e aprovimit 06-10-2005, Data e botimit 28-10-2005;

KOMBET E BASHKUARA
KESHILLI EKONOMIK DHE SHOQEROR

Komisioni Ekonomik per Europen
Mbledhje e Paleve te Konventes per
Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne Kontekst Nderkufitar
(Mbledhja e Jashtezakonshme, Kiev 21 Maj 2003)
(Pika 2 e rendit
te dites)

PROTOKOLLI I VLERESIMIT STRATEGJIK MJEDISOR*

Palet e ketij Protokolli,

Duke njohur rendesine e integritit te problemeve mjedisore dhe te atyre shendetesore ne pergatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe aty ku eshte e mundshme ne politika dhe legjislacion,

Duke u angazhuar ne nxitjen e zhvillimit te qendrueshem dhe si rezultat duke u bazuar ne konkluzionet e Konferences se Kombeve te Bashkuara per Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Janeiro, Brazil, 1992), ne veçanti ne parimet 4 dhe 10 te Deklarates se Rio-s mbi Mjedisin dhe Zhvillimin dhe Axhendes 21, ne rezultatet e Konferences se Trete MinistrORE mbi Mjedisin dhe Shendetesine (Londer, 1999) dhe te Samitit Boteror mbi Zhvillimin e Qendrueshem (Johannesburg, Afrika e Jugut, 2002),

Duke patur parasysh Konventen mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne Kontekst Nderkufitar, nenshkruar ne Espoo, Finlande me 25 Shkurt 1991, dhe vendimin II/9 te Paleve te saj te marre ne Sofje me 27 Shkurt 2001, sipas te cilit eshte vendosur te pergatitet nje protokoll ligjerisht i detyrueshem mbi vleresimin strategjik mjedisor,

Duke pranuar se vleresimi strategjik mjedisor duhet te kete nje rol te rendesishem ne pergatitjen dhe miratimin e planeve, programeve, dhe aty ku eshte e mundur, ne politikat dhe legjislacion, dhe se zbatimi me i gjere i parimeve te vleresimit strategjik mjedisor ne planet, programet, politikat dhe legjislacion do te forcoje me tej analizen sistematike te pasojave te tyre domethenese mjedisore.

Duke marre ne konsiderate Konventen per Akses ne Informacion, per Pjesemarrjen e Publikut ne Vendim-Marrje dhe Akses ne Drejtesi per Çeshtjet Mjedisore, nenshkruar ne Aarhus me 25 Qershor 1998 dhe duke njohur paragrafet perkates se Deklarates se Lucca-s, miratuar ne takimin e pare te Paleve,

Te ndergjegjshem per dhenien rendesi te pjesemarrjes se publikut ne vleresimin strategjik mjedisor,

Duke njohur perfitimet qe do te vijne ne shendetin dhe mireqenien e brezave te sotem dhe atyre te ardhshem nese nevoja per te mbrojtur dhe permiresuar shendetin e popullsisë merret parasysh ne vleresimin strategjik mjedisor, dhe duke mirenjohur punen e drejtuar nga Organizata Boterore e Shendetesise per kete çeshtje,

Duke patur parasysh nevojën dhe rendesine e rritjes se bashkepunimit nderkombetar ne vleresimin e efekteve nderkufitare mjedisore, perfshire edhe shendetesore, te planeve, programeve, dhe aty ku gjen shtrirje, te politikave dhe legjislacionit te propozuar,

* I pergatitur nga Grupi i Punes Ad Hoc per Protokollin e Vleresimin Strategjik Mjedisor per miratimin ne mbledhjen e jashtezakonshme te Paleve te Konventes

Kane rene dakort si me poshte:

Neni 1

QELLIMI

Qellimi i ketij Protokolli eshte te krijoje kushtet per nje nivel me te larte mbrojtjeje te mjedisit, perfshire edhe shendetin, duke:

- a) Siguruar qe çeshtjet mjedisore, perfshi edhe ato shendetesore, jane marre thellesisht ne konsiderate ne zhvillimin e planeve dhe programeve;
- b) Kontribuar ne marrjen ne konsiderate te çeshtjeve mjedisore dhe shendetesore ne pergatitjen e politikave dhe legjislacionit,
- c) Vendosur procedura te qarta, transparente dhe efektive per vleresimin strategjik mjedisor;
- d) Siguruar pjesemarrjen e publikut ne vleresimin strategjik mjedisor; dhe
- e) Integruar me keto mjete çeshtjet mjedisore dhe shendetesore ne masat dhe instrumentet e percaktuara per zhvillim te qendrueshem.

Neni 2

PERKUFIZIME

Per qellimet e ketij Protokolli,

1. “Konvente” i referohet Konventes mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne Kontekst Nderkufitar;
2. “Pale” i referohet nje Pale Kontraktuese te ketij Protokolli, me perjashtim te rastit kur ne tekst ka tjeter indikacion;
3. “Pala e origjines” i referohet Pales ose Paleve te ketij Protokolli brenda juridiksionit te te cilave parashikohet pergatitja e planit ose programit;
4. “Pala e prekur” i referohet Pales ose Paleve te ketij Protokolli te cilat mund te preken nga efekte mjedisore ose shendetesore te planeve ose programeve;
5. “Plane dhe programe” i referohet planeve dhe programeve ose çdo ndryshim ne to qe jane:
 - (a) Kerkuar nga dispozita ligjore, rregullatore ose administrative,
 - (b) Subjekt i pergatitjes dhe/ose aprovimit nga nje autoritet ose pergatitjes nga nje autoritet per aprovim nga parlamenti ose qeveria, nepermjet nje procedure formale;
6. “Vleresim strategjik mjedisor” i referohet vleresimit te efekteve te mundshme mjedisore dhe shendetesore, te cilat perfshijne percaktimin e qellimit te nje raporti mjedisor, pergatitjen e tij, kryerjen e pjesemarrjes se publikut dhe konsultimeve, marrjen ne konsiderate te raporteve mjedisore, te rezultateve te pjesemarrjes se publikut dhe konsultimeve ne nje plan ose program;
7. “Efekt mjedisor dhe shendetesor” i referohet çdo efekti te mjedisit, perfshire shendetin e njeriut, floren, faunen, biodiversitetin, token, klimen, ajrin, ujin,

- peisazhin, sitet natyrore, asetet materiale, trashegimine kulturore dhe nderveprimin ndermjet ketyre faktoreve;
8. “Publiku” i referohet nje ose me shume personave fizike ose juridike dhe, ne perputhje me legjislacionin dhe praktiken vendase, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre.

Neni 3

DISPOZITA TE PERGJTIHSHME

1. Secila Pale do te ndermarre masat e domosdoshme legjislative, rregullatore dhe masa te tjera te nevojshme per te zbatuar dispozitat e ketij Protokolli perms nje kuadri te qarte dhe transparent.
2. Secila Pale do te perpiqet qe zyrtaret dhe autoritetet te ndihmojne dhe udhezojne publikun per ceshtjet e mbuluara nga ky Protokoll.
3. Secila Pale do te sigutoje njohjen dhe mbeshtetjen e ketij Protokolli nga shoqata, organizata ose grupe te cilat nxisin mbrojtjen e mjedisit dhe te shendetit ne kuadrin e ketij Protokolli.
4. Dispozitat e ketij Protokolli nuk do te prekin te drejten e nje Pale per te mbajtur ose ndermarre masa shtese per ceshtjet e mbuluara nga ky Protokoll.
5. Secila Pale do te beje te ditur qellimet e ketij Protokolli ne proceset perkatese vendim-marrese nderkombetare dhe ne kuadrin e organizatave perkatese nderkombetare.
6. Seila Pale do te siguroje qe personat qe ushtrojne te drejtat e tyre ne perputhje me dispozitat e ketij Protokolli nuk do te ndeshkohen, perndiqen ose shtypen ne asnje menyre per perfshirjen e tyre. Kjo dispozite nuk do te preke pushtetin e gjykatave vendase per te dhene gjoba te arsyeshme ne proceset gjyqesore.
7. Brenda qellimit te dispozitave perkatese te ketij Protokolli, publiku duhet te jete ne gjendje te ushtroje te drejtat e tij pa u diskriminuar per arsye nenshtetesisie, kombesie ose vendbanimi, dhe ne rastin e nje personi juridik, pa u diskriminuar per arsye te vendit ku eshte regjistruar ose te qendres efektive te aktiviteve te tij.

Neni 4

FUSHA E APLIKIMIT PER PLANET DHE PROGRAMET

1. Secila Pale do te siguroje qe vleresimi strategjik mjedisor do te kryhet per planet dhe programet sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 te cilat mund te kene pasoje te ndjeshme ne mjedis dhe shendet.
2. Vleresimi strategjik mjedisor duhet te kryhet per planet dhe programet te cilat pergatiten per bujqesine, pyjet, peshkimin, energjine, industrine perfshire minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujrave, telekomunikacion, turizem, planet e perdorimit te tokes per qytetin dhe fshatin, **te cilat vendosin kuadrin per miratimin e ardhshem te** zhvillimit te

- projekteve te listuara ne aneksin I [MSOffice1] dhe te çdo projekti listuar ne aneksin II te cilat kerkojne nje vleresim strategjik mjedisor nen legjislacionin vendas.
3. Per planet dhe programet e tjera nga ato te paragrafit 2 te cilat vendosin kuadrin per miratimin e ardhshem te projekteve, vleresimi strategjik mjedisor do te kryhet aty ku e percakton nje Pale sipas Nenit 5, paragrafi 1.
 4. Per planet dhe programet e permendura ne paragrafin 2 te cilat percaktojne perdorimin e zonave te vogla ne nivel lokal dhe per ndryshime te vogla ne planet dhe programet e permendura ne paragrafin 2, vleresimi strategjik mjedisor do te kryhet vetem ku e percakton nje Pale sipas Nenit 5, paragrafi 1.
 5. Planet dhe programet e meposhtme nuk jane subjekt i ketij Protokolli:
 - (a) Planet dhe programet qellimi i te cilave eshte t'i sherbejne mbrojtjes se vendit ose emergjencave civile;
 - (b) Plane dhe programe financiare ose buxhetore.

Neni 5

SHQYRTIMI

1. Secila Pale do te percaktoje rastet kur planet dhe programet e permendura ne Nenin 4, paragrafet 3 dhe 4, mund te kene pasoja domethenese ne mjedis dhe shendet ose nepermjet nje ekzaminimi rast pas rasti, ose me specifikim te tipeve te planeve dhe programeve, ose duke kombinuar te dyja perqasjet. Per kete qellim, ne te gjitha rastet, secila Pale do te marre ne konsiderate kriteret e vendosura ne aneksin III.
2. Secila Pale do te siguroje qe autoritetet mjedisore dhe shendetesore siç permenden ne Nenin 9, paragrafi 1, do te konsultohen per aplikimin e procedurave te paragrafit 1 si me siper.
3. Aty ku eshte e mundur, secila Pale do te perpiqet te krijojë mundesine e pjesemarrjes se publikut te interesuar ne egzaminimin e planeve dhe programeve te ketij neni.
4. Secila Pale do te siguroje qe konkluzionet pas procedurave te paragrafit 1, perfshire edhe arsyet perse nuk kerkohet vleresim strategjik mjedisor, do te behen te ditura ne kohe me ane te njoftimeve publike ose dhe me mjete te tjera te pershtatshme si mediat elektronike.

Neni 6

SHTRIRJA

1. Secila Pale do te krijojë kushtet per percaktimin e informacionit te rendesishem qe do te perfshihet ne raportin mjedisor ne perputhje me Nenin 7, paragrafi 2.
2. Secila Pale do te siguroje qe autoritetet mjedisore dhe shendetesore te permendura ne Nenin 9, paragrafi 1, te konsultohen gjate percaktimit te informacionit te rendesishem qe do te perfshihet ne raportin mjedisor.
3. Aty ku eshte e mundur, secila Pale do te perpiqet te krijojë mundesite per pjesemarrjen e publikut te interesuar ne percaktimin e informacionit qe do te perfshihet ne raportin mjedisor.

Neni 7

RAPORTI MJEDISOR

1. Per planet dhe programet qe i nenshtrohen vleresimit strategjik mjedisor, secila Pale do te siguroje qe te pergatitet raporti mjedisor.
2. Raporti mjedisor duhet te identifikojë, pershkruaj dhe vleresoje pasojat te rendesishme mjedisore dhe shendetesore qe mund te kene planet ose programet ne zbatim dhe alternativat e tij te arsyeshme, ne perputhje me percaktimet nen nenin 6. Raporti duhet te permbaje kete informacion te specifikuar ne aneksin IV siç mund te kerkohet ne menyre te arsyeshme, duke marre ne considerate:
 - (a) Njohurite dhe metodat aktuale te vleresimit;
 - (b) Permbajtjet dhe nivelin e detajeve te planit ose programit dhe shkallen e tij ne procesin e vendim-marrjes;
 - (c) Interesat e publikut; dhe
 - (d) Nevojat per informacion nga organi vendim-marres.
3. Secila Pale do te siguroje qe raportet mjedisore jane me cilesine e mjaftueshme per t'u pranuar nga kerkesat e ketij Protokolli.

Neni 8

PJESEMARRJA E PUBLIKUT

1. Secila pale do te siguroje mundesi te shpejta, te shpeshta dhe efektive per pjesemarrjen e publikut ne vleresimin strategjik mjedisor te planeve dhe programeve, atehere kur te gjitha mundesite jane te hapura.
2. Secila Pale do te siguroje qe projektet e planeve ose programeve dhe raporti mjedisor te jene te disponueshme per publikun ne kohen e duhur, duke perdorur mediat elektronike ose mjete te tjera te pershtatshme.
3. Secila Pale do te siguroje qe te identifikohet publiku i interesuar per qellimet e pragrafit 1 dhe 4, perfshire ketu organizatat jo-fitimprurese te fushes.
4. Secila Pale do te siguroje qe publiku te cilit i referohet paragrafi 3 te kete mundesine per te shprehur opinionin mbi projektin e planit ose te programit dhe mbi raportin mjedisor brenda nje harku kohor te arsyeshem.
5. Secila Pale do te siguroje qe masat e detajuara per informimin e publikut dhe konsultimin e publikit te interesuar jane percaktuar dhe shpallur publikisht. Per kete qellim, secila Pale do te marre ne konsiderate brenda kufijve te mundshem elementet e listuar ne aneksin V.

Neni 9

KONSULTIMI ME AUTORITETET MJEDISORE DHE SHENDETESORE

1. Secila Pale do te percaktoje autoritetet qe do te konsultohen te cilat mund te preken nga pasojat mjedisore ose shendetesore te zbatimit te planit ose programit, per arsye te pergjegjesive te tyre specifike mjedisore ose shendetesore.
2. Projekti i planit ose programit dhe raporti mjedisor do te jete i disponueshem per autoritetet e permendura ne paragrafin 1.
3. Secila Pale do te siguroje qe autoriteteve te permendura ne paragrafin 1 t'u jepet mundesia te shprehin mendimin e tyre mbi projektin e planit ose programit dhe mbi raportin mjedisor, ne menyre te shpejte, efektive dhe ne kohe.
4. Secila Pale do te percaktoje masat e detajuara per te informuar dhe konsultuar autoritetet mjedisore dhe shendetesore te permendura ne paragrafin 1.

Neni 10

KONSULTIMET NDERKUFITARE

1. Kur Pala e origjines konsideron se zbatimi i nje plani ose programi mund te kete pasoja te rendesishme nderkufitare mjedisore ose shendetesore ose kur Pala qe mund te preket ndjeshem e kerkon, Pala e origjines duhet te njoftoje Palen e prekur sa me shpejt qe te jete e mundur, para zbatimit te planit ose programit.
2. Ky njoftim duhet te permbaje ndermjet te tjerash:
 - (a) Projektin e planit ose programit dhe raportin mjedisor ku te perfshihet informacion mbi pasojat e tij nderkufitare mjedisore ose shendetesore; dhe
 - (b) Informacion mbi proceduren e vendim-marrjes, ku te perfshihet nje afat i arsyeshem kohor per transmetimin e komenteve.
3. Pala e prekur do t'i tregojte Pales se origjines, brenda kohes se specifikuar ne njoftim, se kur deshiron te beje konsultime perpara zbatimit te planit ose programit dhe, nese ndodh keshtu, Palet e interesuara do te hyjne ne konsultime per pasojat e mundshme nderkufitare mjedisore ose shendetesore te zbatimit te planit ose programit dhe masat e menduara per te parandaluar, zvogeluar ose zbutur pasojat negative.
4. Kur ndodhin keto konsultime, Palet e interesuara do te bien dakort per masat e detajuara per t'u siguruar qe publiku i interesuar dhe autoritetet e permendura ne nenin 9, paragrafi 1, te Pales se prekur te jene te informuar dhe t'u jete dhene mundesia e shprehjes se mendimit te tyre mbi projektin e planit ose programit dhe mbi raportin mjedisor brenda nje harku te arsyeshem kohor.

Neni 11

VENDIMI

1. Secila Pale do te siguroje qe gjate zbatimit te nje plani ose programi te merren seriozisht ne konsiderate:
 - (a) Konkluzionet e raportit mjedisor;
 - (b) Masat per te parandaluar, zvogeluar ose zbutur pasojat negative te identifikuara ne raportin mjedisor; dhe
 - (c) Komentet e dhena ne perputhje me nenet 8, 9 dhe 10.
2. Secila Pale do te siguroje qe, kur miratohet nje plan ose program, publiku, autoritetet e permendura ne nenin 9, paragrafi 1, dhe Palet e konsultuara sipas nenit 10, te jene te informuara dhe qe u vene ne dispozicion plani ose programi bashke me nje shpallje qe permblledh sesi çeshtjet mjedisore dhe shendetesore jane perfshire net e, si jane marre ne konsiderate komentet e marra sipas neneve 8,9 dhe 10 dhe arsyet per ta miratuar ate bazuar ne marrjen ne konsiderate te alternativave te arsyeshme.

Neni 12

MONITORIMI

1. Secila Pale do te monitoroje pasojat e ndjeshme mjedisore ose shendetesore te zbatimit te planit ose programit, te miratuara ne nenin 11, ne menyre qe ndermjet te tjerash, te identifikojne ne nje faze te hershme pasoja negative te paparashikuara dhe te jete ne gjendje te ndermarre masat e nevojshme rregulluese.
2. Rezultatet e monitorimit te kryer do te jene te disponibel, ne perputhje me legjislacionin kombetar, per autoritetet e permendura ne nenin 9, paragrafi 1 dhe per publikun.

Neni 13

POLITIKAT DHE LEGJISLACIONI

1. Secila Pale do te perpiqet te siguroje qe çeshtjet mjedisore dhe shendetesore te merren ne konsiderate dhe te integrohen ne masen e duhur ne perгатitjen e propozimeve te saj per politikat dhe legjislacionin qe mund te kete pasoja te ndjeshme ne mjedis dhe ne shendet.
2. Ne aplikimin e paragrafit 1, secila Pale do te marre parasysh parimet dhe elementet e duhur te ketij Protokolli.
3. Secila Pale do te percaktojte, aty ku eshte e pershtatshme, masat praktike per marrjen ne konsiderate dhe perfshirjen e çeshtjeve mjedisore dhe shendetesore ne

perputhje me paragrafin 1, duke patur parasysh nevojen per transparence ne vendim-marrje.

4. Secila Pale do te raportoje ne Mbledhjen e Paleve te Konventes qe do te jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli per zbatimin e ketij neni.

Neni 14

MBLEDHJA E PALEVE TE KONVENTES DO TE JETE EDHE MBLEDHJE E PALEVE TE KETIJ PROTOKOLLI

1. Mbledhja e Paleve te Konventes do te sherbeje edhe si Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli. Mbledhja e pare e Paleve te Konventes qe do te jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli do te mblidhet jo me vone se nje vit pas hyrjes ne fuqi te ketij Protokolli, dhe ne kombinim me Mbledhjen e Paleve te Konventes, nese nje mbledhje e kesaj te fundit eshte planifikuar per ate periudhe. Mbledhjet e mepasme te Paleve te Konventes qe do te jene edhe Mbledhje te Paleve te Protokollit do te kombinohen me Mbledhjet e Paleve te Konventes, me perjashtim te rastit kur vendoset ndryshe nga Mbledhja e Paleve te Konventes qe do te jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli.
2. Palet e kesaj Konvente qe nuk jane Pale te ketij Protokolli mund te marrin pjese si vezhgues ne zhvillimin e çdo sesioni te Mbledhjes se Paleve te Konventes qe do te jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli. Kur Mbledhja e Paleve te Konventes sherben edhe si Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli, vendimet nen kete Protokoll do te merren vetem nga Palet e ketij Protokolli.
3. Kur Mbledhja e Paleve te Konventes eshte edhe Mbledhje e Paleve te Protokollit, çdo anetar i Byrose se Mbledhjes se Paleve qe perfaqeson nje Pale ne Konvente qe ne kete moment nuk eshte Pale e ketij Protokolli do te zevendesohet me nje anetar tjetër qe do te zgjidhet nga dhe ndermjet Paleve te ketij Protokolli.
4. Mbledhja e Paleve e Konventes qe do jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli do te rishikojë rregullisht zbatimin e ketij Protokolli dhe, per kete qellim, do te:
 - (a) Rishikojë politikat dhe perqasjet metodologjike per vleresimin strategjik mjedisor me qellimin per te permiresuar procedurat e pershkruara ne kete Protokoll;
 - (b) Shkembeje informacion rreth pervojes se fituar ne vleresimin strategjik mjedisor dhe ne zbatimin e ketij Protokolli;
 - (c) Kerkoje, aty ku shihet e pershtatshme, sherbimet dhe bashkepunimin e organizmave kompetente qe kane pervojen e duhur per realizimin e qellimeve te ketij Protokolli.
 - (d) Krijojë organizma te tille subsidiare si ta gjykoje te nevojshme per zbatimin e Protokollit;
 - (e) Te marre ne konsiderate dhe te parroje propozime per amendimin e ketij protokolli kur eshte e domosdoshme; dhe
 - (f) Te marre ne konsiderate dhe te ndermarre çdo veprim tjetër, perfshire veprime per t'u ndermarre se bashku nen kete Protokoll dhe nen

Konvente, te cilat mund te nevojiten per realizimin e qellimeve te ketij Protokolli.

5. Rregullat e procedurave te Mbledhjes se Paleve te Konventes do te aplikohen mutatis mutandis per kete Protokoll, me perjashtim te rastit kur vendoset ndryshe me Konsensus nga Mbledhja e Paleve qe sherben si Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli.
6. Ne takimin e saj te pare, Mbledhja e Paleve te Konventes qe sherben si Mbledhje e Paleve te ketin Protokolli do te marre ne considerate dhe do te miratoje modalitetet per te aplikuar procedurat per rishikimin e perputhshmerise me Konventen e ketij Protokolli.
7. Secila Pale do te raportoje ne Mbledhjen e Paleve te Konventes qe do te jete edhe Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli per masat qe ka marre per zbatimin e Protokollit, ne intervale kohe te percaktuara nga Mbledhja e Paleve te Konventes qe sherben edhe si Mbledhje e Paleve te ketij Protokolli.

Neni 15

MARREDHENIET ME MARREVESHJE TE TJERA NDERKOMBETARE

Dispozitat e ketij Protokolli do te zbatohen pa paragjykim ndaj Konventes per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne Kontekst Nderkufitar dhe Konventes per Akses ndaj Informacionit, Pjesemarrjes se Publikut ne Vendim-marrje dhe Akses ne Drejtesi per Çeshtjet Mjedisore te UNECE-s (Komisioni Ekonomik per Europen i Kombeve te Bashkuara).

Neni 16

E DREJTA E VOTES

1. Pervec rastit te permendur ne paragrafin e meposhtem, secila Pale e ketij Protokolli do te kete nje vote.
2. Organizatat e integritit ekonomik rajonal do te ushtrojne te drejten e votes, per çeshtjet Brenda kompetences se tyre, me nje numer votash te barabarte me numrin e Shteteve te tyre anetare te cilat jane Pale e ketij Protokolli. Keto organizata nuk do te ushtrojne te drejten e votes nese Shtetet e tyre anetare ushtrojne te veten, dhe anasjelltas.

Neni 17

SEKRETARIATI

Sekretariati i krijuar sipas nenit 13 te Konventes do te sherbeje si sekretariat i ketij Protokolli dhe neni 13, paragrafi (a) deri (c), i Konventes mbi funksionet e sekretariatit do te zbatohet mutatis mutandis per kete Protokoll.

Neni 18
ANEKSET

Anekset e ketij Protokolli do te perbejne pjese integrale te tij.

Neni 19
AMENDIMET E PROTOKOLLIT

1. Çdo Pale mund te propozoje amendime te Protokollit.
2. Subjekti i paragrafit 3, procedurat e propozimit, miratimit dhe hyrjes ne fuqi te nje amendimi te Konventes te percaktuara ne paragrafet 2 deri 5 te nenit 14 te Konventes do te zbatohen mutatis mutandis per amendimet e ketij Protokolli.
3. Per qellimet e ketij Protokolli, tre te katertat e domosdoshme te Paleve qe kane ratifikuar, miratuar ose pranuar ate, per hyrjen ne fuqi te nje amendimi do te llogariten ne baze te numrit te Paleve ne momentin e miratimit te amendimit.

Neni 20
ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Dispozitat mbi zgjidhjen e konflikteve te nenit 15 te Konventes do te aplikohen mutatis mutandis per kete Protokoll.

Neni 21
NENSHKRIMI

Ky Protokoll do te hapet per nenshkrim ne Kiev (Ukraine) nga 21 deri me 23 Maj 2003 dhe me pas ne Zyrat Qendore te Kombeve te Bashkuara ne New York deri ne 31 Dhjetor 2003. Protokolli mund te nenshkruhet nga Shtetet anetare te Komisionit Ekonomik per Europen si dhe Shtetet me status konsultativ prane Komisionit Ekonomik per Europen sipas paragrafit 8 dhe 11 te Rezolutes se Keshillit Ekonomik dhe Social 36 (IV) te 28 Mars 1947, dhe nga organizatat e integritit ekonomik te perbera nga Shtete suverane anetare te Komisionit Ekonomik per Europen tek te cilat Shtetet anetare kane transferuar kompetenca mbi çeshtjet qe mbulon ky Protokoll, perfshire edhe kompetencen per te nenshkruar traktate per keto çeshtje.

Neni 22
DEPOZITUESI

Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara do te kryeje funksionin e Depozituesit te ketij Protokolli.

Neni 23
RATIFIKIMI, PRANIMI, MIRATIMI DHE HYRJA

1. Ky Protokoll do te jete subject ratifikimi, pranimi ose miratimi nga Shtetet nenshkruese dhe organizatat rajonale te integritit ekonomik te permendura ne nenin 21.
2. Ky Protokoll do te hapet per hyrje nga 1 Janari 2004 per Shtetet dhe organizatat rajonale te integritit ekonomik te permendura ne nenin 21.
3. Çdo Shtet tjetër, i cili nuk është permendur në paragrafin 2 të mesipër, që është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të hyjë në Protokoll pas miratimit të Mbledhjes së Paleve të Konventës që do të jete edhe Mbledhje e Paleve të këtij Protokoll.
4. Çdo organizatë rajonale e integritit ekonomik e permendur në nenin 21 e cila bëhet Pale e këtij Protokoll pa asnjë nga Shtetet e saj anëtare përjashtohet nga të gjitha detyrimet e këtij Protokoll. Nëse një ose më shumë Shtete që janë Pale të këtij Protokoll janë edhe anëtare të organizatave të tilla, organizata dhe Shtetet e saj anëtare do të vendosin për përgjegjësitë përkatëse për përbushjen e detyrimeve në këtë Protokoll. Në këto raste, organizata dhe Shtetet e saj anëtare nuk do të ushtrojnë të drejtat e tyre në këtë Protokoll në të njëjtën kohë.
5. Në instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, organizatat rajonale të integritit ekonomik të permendura në nenin 21 do të deklarojnë shtrirjen e kompetencave të tyre mbi çështjet e rregulluara nga ky Protokoll. Këto organizata do të informojnë gjithashtu Depozituesin për çdo ndryshim të rëndësishëm për shtrirjen e kompetencave të tyre.

Neni 24
HYRJA NË FUQI

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nentëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes.
2. Për qëllimet e paragrafit 1 më sipër, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik i permendur në nenin 21 nuk do të llogaritet si instrument shtesë të atyre të depozituara nga Shtetet anëtare të këtyre organizatave.
3. Për çdo Shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik, të permendur në nenin 21, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë Protokoll ose hyn në të pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, Protokollin do të hyjë në fuqi në ditën e nentëdhjetë pas datës së depozitimit nga ky Shtet ose organizatë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes.
4. Ky Protokoll do të zbatohet për plane, programe, politika dhe legjislacion për të cilin akti i parë formal përgatitor është pasardhës i datës në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi. Kur Pala në juridiksionin e së cilës është projektuar përgatitja e një plani, programi, politike apo legjislacioni është njëra për të cilën zbatohet

paragrafi 3, ky Protokoll do te zbatohet per plane, programe, politika dhe legjislacion per te cilat akti i pare formal pergatitor eshte pasardhes ndaj dates ne te cilen Protokolli hyn ne fuqi per ate Pale.

Neni 25
TERHEQJA

Ne çdo moment, kater vjet pas dates ne te cilen ky Protokoll ka hyre ne fuqi per nje Pale, kjo Pale mund te terhiqet nga Protokolli duke njoftuar me shkrim Depozituesin. Çdo terheqje e tille do te kete efekt ditën e nentëdhjetë pas dates se marrjes se tij nga Depozituesi. Asnje terheqje e tille nuk do te preke zbatimin e nenit 5 deri 9, 11 dhe 13 per vleresimin strategjik mjedisor nen kete Protokoll i cili ishte tashme i filluar, ose zbatimin e nenit 10 per njoftimin ose kerkesen i cili ishte bere, para se kjo terheqje te kete efekt.

Neni 26
TEKSTI AUTENTIK

Origjinali i ketij Protokolli, teksti anglisht, frengjisht dhe rusisht i te cilit jane njesoj autentike, do te depozitohet tek Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara.

Te nenshkruarit, ne prani te deshmitareve te pranishem, duke qene plotesisht te autorizuar per kete, kane firmosur kete Protokoll.

Bere ne Kiev (Ukraine), sot me njezetën Maj, dy mije e tre.

Aneksi I

LISTA E PROJEKTEVE REFERUAR NENIT 4, PARAGRAFI 2

1. Rafinerite e naftes (duke perjashtuar ndermarrjet qe prodhojne lubrifikante nga nafta bruto) dhe impinatet e lengezimit dhe perpunimit te 500 metrik ton qymyr ose rere bituminoze ne dite.
2. Termocentrale te prodhimit te energjise dhe impiante te tjera te djegjes me prodhim nxehtesie prej 300 MV ose me shume dhe stacionet berthamore dhe reaktoret e tjere berthamore (duke perjashtuar impiantet kerkimore, fuqia maksimum e te cileve nuk kalon 1 kilowatt ngarkese termike te vazhdueshme).
3. Impiante per prodhimin ose pasurimin e lendeve djegese berthamore, per riperpunimin e lendeve djegese berthamore te rezatuara ose per ruajtje, depozitim dhe perpunimin e mbetjeve radioaktive.
4. Impiantet e medhenj per shkrirjen fillestare te gizes dhe celikut dhe per prodhimin e metaleve pa permbajtje hekuri.
5. Impiantet per nxjerrjen e asbestit dhe per perpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve qe permbajne asbest: per produktet e asbest-çimentos, me nje prodhim vjetor prej me shume se 20.000 metrik ton te produktit perfundimtar; per fraksionimin e materialit, me nje prodhim vjetor prej me shume se 50 metrik ton te produktit perfundimtar; dhe per prodhimin e asbesteve te tjera prej me shume se 200 metrik ton ne vit.
6. Impiantet e integruar kimike.
7. Ndertimi i rrugeve automobilistike, rrugeve ekspres * dhe linjave te trafikut hekurudhor te distancave te gjata dhe te aeroporteve ** me gjatesi baze kalueshmerie prej 2100 metra ose me shume .
8. Tubacionet me diameter te madh per transportimin e naftes dhe gazit.
9. Portet e tregtimit dhe gjithashtu ruget ujore ne brendesi te tokes dhe portet per trafikun uJOR ne brendesi te tokes qe lejojne kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 ton.
10. Impiante per djegje, trajtim kimik, ose groposje te mbeturinave toksike dhe te rrezikshme.
11. Depozitat e medha dhe rezervuaret.
12. Aktivitete te nxjerrjes se ujrave nentokesore ne rastet kur volumi vjetor i ujit qe do te nxirret eshte 10 000 milion m³ .
13. Prodhimi i pulpes dhe letres me kapacitet prodhues 200 ton/dite ose me shume.
14. Miniera te medha , nxjerrja dhe perpunimi i metaleve ose qymyrit.
15. Prodhimi i hidrokarbureve ne det.
16. Depozita te medha per magazinimin per qellime tregtimi apo ruajtje per naften, produktet e naftes, dhe produktet kimike.
17. Shpyllezimi i zonave te medha.

Per qellime te ketij Protokolli:

* “Autostrade” do te thote nje rruge e projektuar dhe e ndertuar per trafik automobilistik, e cila nuk u sherben zonave perreth, dhe e cila:

- a. Lejohet, vetem ne pika te vecanta ose perkohesisht, me karrexhata te ndara per dy drejtimet e trafikut, te ndara nga njera-tjetra nga nje shirit ndares jo i lejueshem per trafikun, ose ne raste te rralla, me mjete te tjera;
- b. Nuk te jete ne te njejtin nivel me asnje rruge, hekurudhe, shina tramvaji ose rruge kembesoreshe; dhe
- c. Eshte e sinjalizuar vetem si autostrade.

* “Rruge ekspres” do te thote nje rruge e rezervuar per trafik makinash te lejuara vetem nga lidhjet shumekalimeshe ose nyjet e kontrolluara dhe ne te cilen parkimi dhe ndalimi jane te ndaluara pergjate korsive.

** Per qellime te ketij Protokolli, “Aeroport” do te thote nje aeroport qe perputhet me percaktimin e Konventes se Çikagos te vitit 1944 per krijimin e Organizates se Aviacionit Civil (aneksi 14).

Aneksi II
ÇDO PROJEKT TJETER SIPAS NENIT 4, PARAGRAFI 2

1. Projekte per ristrukturimin e zonave rurale.
 2. Projekte per perdorimin e tokave jo bujqesore ose zonave gjysem natyrore per qellime te bujqesise intensive.
 3. Projekte te menazhimit te ujrave per nevoja bujqesore duke perfshire projektet e vaditjes dhe drenazhimit te tokes.
 4. Impiante intensive te rritjes se bagetive (duke perfshire pularite).
 5. Pyllezimi dhe shpyllezimi per qellime te ndryshimit te destinacionit te perdorimit te tokes.
 6. Fermat intensive te peshkimit.
 7. Stacionet berthamore dhe reaktoret e tjere berthamore* qe perfshijne dhe çmontimin dhe nxjerrjen jashte perdorimit te ketyre stacioneve ose reaktoreve (duke perjashtuar impiantet kerkimore, fuqia maksimum e te cileve nuk kalon 1 kilowatt ngarkese termike te vazhdueshme), ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
 8. Ndertimi i linjave elektrike te tensionit te larte me voltazh 220 kilovolt ose me shume dhe nje gjatesi 15 km ose me shume dhe projekte te tjera per transmetimin e energjise elektrike nga kabllot kryesore.
 9. Impiantet industriale per prodhimin e energjise elektrike, avullit dhe ujit te nxehte.
 10. Impiantet industriale per mbajtjen e gazit, avullit dhe ujit te nxehte.
 11. Ruajtja ne sipërfaqe e lendeve te djegshme dhe gazit natyror.
 12. Ruajtja nen toke e gazeve te djegshem.
 13. Briketimi industrial i qymyrit dhe i linjtit.
 14. Impiantet per prodhimin e energjise hidroelektrike.
 15. Impiante per perdorimin e fuqise se eres per prodhimin e energjise.
 16. Impiantet qe nuk jane perfshire ne aneksin I te konceptuara :
 - Per prodhimin dhe pasurimin e lendeve djegese berthamore;
 - Per perpunimin e lendeve djegese berthamore te rezatuara;
 - Per depozitimin perfundimtar te lendeve djegese berthamore te rezatuara;
 - Vetem per depozitimin perfundimtar te mbetjeve radioaktive;
 - Vetem per ruajtjen (planifikuar per me shume se 10 vjet) te lendeve djegese berthamore te rrezatuara ne nje vend te ndryshem nga ai i prodhimit;
 - Per perpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive.
 17. Guroret, minierat e hapura (karierat) dhe nxjerrja e torfes, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
-

* Per qellim te ketij Protokolli, stacionet berthamore dhe reaktoret e tjere berthamore pushojne se qeni te tille kur te gjitha lendet djegese berthamore ose elemente te tjere te ndotur nga radioaktiviteti jane hequr perfundimisht nga stacioni.

18. Minierat nentokesore, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
19. Nxjerrja e mineral-inerteve nga drenazhimi detar ose lumor;
20. Shpimet e thella, ne veçanti (shpimet gjeotermike, shpimet per ruajtjen e mbetjeve berthamore, shpimet per furnizimet me uje), duke perjashtuar shpimet per te kontrolluar qendrueshmerine e tokes.
21. Impiante industriale siperfaqesore per nxjerrjen e qymyrit, naftes, gazit natyror si dhe reres bituminoze.
22. Vepra te integruara per shkrirjen fillestare te gizes dhe çelikut dhe per prodhimin e metaleve pa permbajtje hekuri, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
23. Impiante per prodhimin e gizes dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar), duke perfshire derdhjen e vazhdueshme.
24. Impiante per perpunimin e metaleve te hekurit (uzina te petezimit, kovaçana me çekiçe, aplikimi i veshjeve mbrojtese me metal te perzier).
25. Fonderi te metaleve te hekurit.
26. Impiante per prodhimin e metaleve jo ferrike nga mineralet, koncentratet ose lendet dytesore te proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
27. Impiante per perzjerjen, duke perfshire aliazhet, e metaleve jo ferrike duke perjashtuar metalet me vlere dhe duke perfshire produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja ne fonderi etj.), ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
28. Uzina per trajtimet siperfaqesore te metaleve dhe materialeve plastike, duke perdorur nje proces elektrolitik ose kimik.
29. Impiante per prodhimin dhe montimin e automjeteve dhe prodhimi i motorreve per automjete.
30. Molot.
31. Impiante per prodhimin dhe riparimin e avioneve.
32. Prodhimi i pajisjeve hekurudhore.
33. Hedhje ne ere me eksploziv.
34. Impiante per pjekjen dhe sinterimin e mineraleve metalike.
35. Furrat e koksit (distilim i thate i qymyrit).
36. Impiante per prodhimin e çimentos.
37. Impiante per prodhimin e qelqit dhe te fibrave te qelqit.
38. Impiante per shkrirjen e substancave minerale duke perfshire edhe fibrat minerale.
39. Prodhimi i produkteve qeramike me ane te djegies, ne menyre te veçante tjegullat e çative, tullave, tulla refraktare, tjegulla, veshje guri, ose porcelani.
40. Impiante per prodhimin e kimikateve ose trajtimin e produkteve te ndermjetem, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
41. Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojrave dhe varakut, elastomereve dhe peroksideve.

42. Impiante per magazinimin per qellime tregtimi apo ruajtje per naften, produktet e naftes, dhe produktet kimike, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
43. Prodhimi i vajerave dhe yndyrnave shtazore dhe bimore.
44. Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore.
45. Prodhimi i produkteve bulmetore.
46. Fermentimi i birres.
47. Prodhimi i shurupeve dhe embelsirave.
48. Impiante per therjen e kafsheve (thertore).
49. Impiante per perpunimin e amidonit industrial.
50. Fabrikat per peshkun dhe vajin e peshkut.
51. Fabrikat e sheqerit.
52. Impiante industriale per prodhimin e pulpes, letres dhe fibrave te tjera te ngjashme, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
53. Impiantet per trajtimin paraprak ose ngjyrosjen e fibrave dhe tekstileve.
54. Impiante per trajtimin e lekureve dhe thundrave.
55. Impiante per perpunimin dhe prodhimin e celulozes.
56. Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me baze elastomeri.
57. Impiante per prodhimin e fibrave minerale artificiale.
58. Impiante per rikuperimin dhe shkaterrimin e lendeve eksplozive.
59. Impiantet per prodhimin e asbestit dhe per perpunimin e produkteve te asbestit, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
60. Vend grumbullimi dhe thertore per kafshe ne fund te jetes.
61. Banka prove per motorra, turbina dhe reaktore.
62. Rruge permanente qe perdoren per kryerjen e garave dhe provave per mjete te motorizuara.
63. Tubacionet per transportimin e gazit ose naftes, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
64. Tubacionet per transportimin e kimikateve me diameter prej me shume se 800 mm dhe gjatesi me shume se 40 km.
65. Ndertimi i hekurudhave, faciliteteve intermodale dhe transportit dhe terminaleve intermodale, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
- 66.
67. Ndertimi per tramvajet, ashensorët dhe hekurudhat e nendheshme, te perdorura vetem ose kryesisht per transport pasagjeresh.
68. Ndertimi i rrugeve, duke perfshire rregullimet dhe/ose zgjerimet e rrugeve ekzistuese, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
69. Ndertimi i porteve dhe instalimeve portuale, duke perfshire edhe portet e peshkimit, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
70. Ndertimi i rrugeve ujore ne brendesi te tokes dhe portet per trafikun ujor ne brendesi te tokes, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
71. Portet e tregtimit, molot per ngarkim shkarkim te lidhura me token ose porte te jashtem, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
72. Punimet per kanalizimet dhe drenazhimet
73. Ndertimi i aeroporteve** dhe i fushave per avione, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
74. Impiante per depozitimin e mbetjeve, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.

75. Impiante per djegie ose trajtim kimik te mbeturinave te rrezikshme.
76. Magazinimi i skrapit te hekurit, duke perfshire edhe skrapin e mjeteve levizese.
77. Vend depozitime te mbetjeve te trajtuara.
78. Nxjerrja e ujrave nentokesore ose skemat artificiale te ringarkimit te ujrave nentokesore, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
79. Punime per transferimin e burimeve ujore ndermjet baseneve lumore.
80. Impiante te trajtimit te ujrave te zeza.
81. Dampat dhe rezervuaret e tjera te projektuara per te projektuara per te mbajtur uje ose per ta ruajtur ate per nje kohe te gjate, ato qe nuk jane te perfshira ne aneksin I.
82. Punimet ne bregdet per te luftuar erozionin dhe punimet qe do te ndryshojne bregdetin gjate ndertimit, si psh. Digat, molot dhe punime te tjera mbrojtese detare, duke perjashtuar mirembajtjen dhe rikonstruktimin e punimeve te tilla.
83. Ujesjelles te distancave te gjata.
84. Teleferiket e skive, ashensoret e skive dhe makina me kablllo dhe zhvillimet e shoqeruara me keto lloj veprimtarish.
85. Marinat.
86. Fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashte zonave urbane dhe zhvillimet e shoqeruara me keto lloj veprimtarish.
87. Zonat e karavaneve dhe kampingjet.
88. Parqet zbavitese.
89. Projekte te zhvillimeve industriale.
90. Projekte te zhvillimeve urbane, duke perfshire edhe ndertimin e qendrave tregtare dhe parkimet e makinave.
91. Perftim i tokave nga uji i detit.

** Per qellime te ketij Protokolli, me “aeroport” do te kuptojme nje aeroport qe eshte konform me percaktimin e Konventes se Çikagos te vitit 1944 per krijimin e Organizates se Aviacionit Civil (aneksi 14).

Aneksi III

KRITERET PER PERCAKTIMIN E PASOJAVE TE MUNDSHME MJEDISORE DHE SHENDETESORE SERIOZE, PASOJAT I REFEROHEN NENIT 5, PARAGRAFI 1.

1. Rendesia e planit ose programit ne integrimin e çeshtjeve mjedisore dhe shendetesore ne veçanti me synimin e nxitjes se zhvillimit te qendrueshem.
2. Shkalla ne te cilen plani ose programi krijon nje kuader per projektet dhe aktivitetet e tjera, qofte per vendosjen, natyren, permasen dhe kushtet e punes, qofte duke dhene fonde.
3. Shkalla net e cilen plani ose programi influencon plane ose programe te tjera, perfshire edhe ato te vendosura sipas nje hierarkie.
4. Problemet mjedisore dhe shendetesore te planit ose programit.
5. Natyra e pasojave mjedisore dhe shendetesore, si mundesia qe te ndoshin, kohezgjatja, shpeshtesia, riparimi, magnituda dhe perhapja (si zona gjeografike ose numri i popullsise qe mund te preket).
6. Rreziqet ne mjedis dhe shendetesi.
7. Natyra nderkufitare e pasojave.
8. Shkalla ne te cilen plani ose programi do te preke zona me vlere ose delikate, perfshire peisazhe me status mbrojtjeje kombetar ose nderkombetar te njohur.

Aneksi IV

INFORMACIONI SIPAS NENIT 7, PARAGRAFI 2

1. Permbajtja dhe objektivat kryesore te planit ose programit dhe lidhjet e tij me plane ose programe te tjere.
2. Aspektet e rendesishme te gjendjes aktuale te mjedisit, perfshire shendetesine, dhe zhvillimet e mundshme ne rastin kur plani ose programi nuk do te zbatoheshin.
3. Karakteristikat e mjedisit, perfshire edhe shendetesine, ne zonat qe mund te preken ne menyre domethenese.
4. Problemet mjedisore, edhe ato shendetesore, te rendesishme per planin ose programin.
5. Objektivat mjedisore dhe shendetesore te vendosura ne planin nderkombetar, kombetar ose ne nivele te tjera te cilat jane te rendesishme per planin ose programin, si dhe menyrat ne te cilat keto objektiva dhe çeshtje te tjera mjedisore dhe shendetesore jane marre ne konsiderate gjate perгатitjes se tyre.
6. Pasojat* domethenese mjedisore dhe shendetesore siç jane percaktuar ne nenin 2, paragrafi 7.
7. Masat per te parandaluar, reduktuar ose lehtesuar çdo pasoje negative ne mjedis dhe ne shendet te cilat dalin se rrjedhoje nga zbatimi i planit ose programit.
8. Nje pershkrim i arsyeve per te zgjedhur alternativat e diskutuara se bashku me nje pershkrim se si eshte bere vleresimi, perfshire ketu edhe veshtiresite ne dhenien e informacionit qe do te perfshijne mangesite teknike dhe mungesen e njohurive.
9. Masat e parashikuara per te monitoruar pasojat mjedisore dhe shendetesore te zbatimit te planit ose programit.
10. Pasojat e mundshme dhe te rendesishme nderkufitare mjedisore dhe shendetesore.
11. Nje permbledhje jo teknike e informacionit te dhene.

* Keto pasoja duhet te perfshijne efektet anesore, mbivendosese, sinergjike, afatshkurter, afatmesem, afatgjate, te perhershme dhe te perkoheshme, ato positive dhe negative.

Aneksi V

INFORMACIONI SIPAS NENIT 8, PARAGRAFI 5

- 1) Plani ose programi i propozuar dhe natyra e tij.
- 2) Autoriteti pergjegjes per miratimin e tij.
- 3) Procedurat e parashikuara, perfshire edhe:
 - a. Fillimin e procedures;
 - b. Mundesine e pjesemarrjes se publikut;
 - c. Kohen dhe vendin e konsultimit te parashikuar me publikun;
 - d. Autoritetin prej te cilit mund te merret informacioni i duhur dhe ku ky informacion eshte depozituar per shqyrtim nga publiku.
 - e. Autoritetin tek i cili duhen depozituar komentet dhe pyetjet si dhe kohen e percaktuar per transmetimin e komenteve dhe pyetjeve; dhe
 - f. Çfare informacioni mjedisor dhe shendetesor lidhur me planin ose programin e propozuar eshte i disponueshem.
- 4). Kur plani ose programi do te jete subjekt i procedures se vleresimit nderkufitar.